



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 04.04.2023
PRIMJENJ:
Nr. Nr. Pr. 02/186



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/_____

Datë: 04.04.2023.

Në bazë të nenit 8, nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17, nenit 24, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (c), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2, paragrafi 2.1,2.3, të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 8, paragrafi 9 të Rregullores Nr.02/236 datë: 13.05.2022 për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 shkronja (b), nenit 40, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e tretë (III) të rregullt të mbajtur me datë: 30.03.2023 merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa nr.01/425 datë:20.03.2023 e parashtruar nga kryetari i komunës për mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara me rastin e djegies nga zjarri të stallës së bagëtisë.
2. Bazuar në pikën e 1 të këtij vendimi [redacted] fshati Kërvasari i ndahen mjetet financiare në shumë prej 1.000.00 (një mijë euro), për mbulimin e shpenzimeve të shkaktuara me rastin e djegies nga zjarri të stallës së bagëtisë.
- 2.1. Mjetet në shumë prej 1.000.00 euro (një mijë euro) ndahen nga kategoria e subvencioneve-blloku kodues 21/625/47013/200/00000/0421 nga Drejtoria e Bujqësisë.
3. Këtij vendimi i bashkangjiten: kërkesa, raportet mjekësore dhe kopja e letërnjoftimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit nr.03/040, për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.06.2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

